VENDIM
Nr. 192, datë 30.8.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E APLIKIMIT TË SHOQËRISË "AEE" SHPK, PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të nenit 16, nenit 37, pika 2, germa "d", të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", nenit 4, pika 1, germa "e"; nenit 5, pika 1, germa "e"; nenit 10, pikat 1 dhe nenit 3, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënie, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016 dhe nenit 19, pika 1, germa "a", të "Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.8.2018, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "AEE" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe të Monitorimit të Tregut për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "AEE" sh.p.k., për licencim në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Shoqëria "AEE" sh.p.k., me shkresën nr. 555 prot., datë 16.8.2018, ka paraqitur kërkesën për t'u pajisur me licencë në veprimtarinë e tregtimit.

Aplikimi i shoqërisë "AEE" sh.p.k. plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, germat "a", "b", "c") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, germat "a", "b", "c", "d" dhe "e") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, germat "a", "b", "c" dhe "d") është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni teknik për veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4.8, germat "a", "b", "c", "d") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për shqyrtimin e aplikimit të shoqërisë "AEE" sh.p.k., për licencim në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti